

SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHËSHME

PROFILI NATYROR

Udhëzime për vlerësimin

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përmban një total prej **50 pikësh**.
- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në poezi dhe një në prozë.
- Secila pjesë ka nga 10 pyetje dhe përkatësisht 25 pikë.
- Kërkesat janë të dy tipeve: me zgjedhje dhe me zhvillim.
- Kërkesat me zgjedhje vlerësohen me 1 pikë.
- Kërkesat me zhvillim vlerësohen nga 3 deri në 6 pikë.
- Në secilën pjesë kërkesa e fundit është e tipit ese (me fund të hapur).
- Kërkesat me zhvillim do të vlerësohen në bazë të një skeme orientuese të detajuar.

Në vlerësimin e pyetjeve ese duhet patur parasysh:

- Përgjigja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe nëse ajo që ka shkruar është interesante dhe origjinale apo jo.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të pyetjes, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe pyetjes, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni** se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA II

SHEKSPIR – MAKBETH

Kërkesa 11	C
Kërkesa 12	B
Kërkesa 13	A
Kërkesa 14	D
Kërkesa 15	B
Kërkesa 16	4 pikë

Model përgjigjeje

- Cilësitë e karakterit të Bakos: i matur, dyshues, ironik, i ndershëm, besnik i mbretit.
- Ilustrime nga fragmenti: *Si, s'paskë rënë edhe?*(Ironik, dyshues)
Nuk e humbas, kur dua të rrit nderin,
Po me ndërgjegje dhe besnikëri; (besnik, i ndershëm)
Mund ta mejtojmë (ironik, i matur)
- Cilësi të Makbethit: i shtirur, hipokrit, me dilema, ambicioz, me ndërgjegje të trazuar, krenar, me shumë imagjinatë etj
- Ilustrime: *Nuk ishim përgatitur për vizitën;*
Rob i mungesës ish vullneti ynë,
Se ndryshe do shfaqej më lirisht. (hipokrit, i shtirur)
- Etj.

1 pikë nëse shkruan cilësi të karakterit të Bankos.

1 pikë nëse i ilustron me vargje këto cilësi.

1 pikë nëse shkruan cilësi të karakterit të Makbethit.

1 pikë nëse i ilustron me vargje këto cilësi.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 17 3 pikë

Model përgjigjeje

- Nata.
- Funkzioni artistik është ai i krijimit të ankthit. Nata mbart të papritura, të fshehta. Te spektatori krijon një lloj gjendjeje ankthi, tensioni dhe padurimi për atë çfarë mund të ndodhë më pas.

Matura Shtetërore 2006, Teste

- Nata e mbështjell dhe vetë situatën me një mister duke e bërë enigmatike; çfarë do të ndodhë, kur, etj.
- Është simbol i së keqes, të paktën në këtë kontekst. Është simbol i krimin që do të ndodhë.
- Etj.

1 pikë përcaktimi i saktë i kohës..

2 pikë nëse interpreton saktë funksionin artistik të saj, duke dëshmuar se e ka kuptuar si duhet thelbin e figurës dhe të tërë tragjedisë.

1 pikë nëse e shpjegon pjesërisht funksionin e saj.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Do të pranohen si të sakta edhe përgjigje të tjera, që gjykohen si të tilla nga komisioni i vlerësimit.

Kërkesa 18 4 pikë

Model përgjigjeje

- Aliteracioni – *d, a, k, f, rr*.
- Funkcioni: Krijon përshtypjen e goditjes, të kumbimit, të jehonës, sikur dëgjon me të vërtetë goditjen e kabanës. Ideja është ajo e goditjes në ndërgjegje, e makthit, e dyzimit dhe parandjenjës së asaj që do të ndodhë pas pak.
- Ndjenja që nxit është ajo e tmerrit, e frikës e aknithit, etj.

1 pikë nëse gjen aliteracionin

2 pikë nëse jep tingujt përbërës të tij dhe shpjegon qartë efektin që krijohet nga kjo përsëritje.

1 pikë nëse tregon ndjenjat që i lindin dhe pse.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shpjegimi është i lirë, por nxënësi duhet të tregojë se e ka kuptuar qartë dhe fokusohet si duhet në atë që përbën thelbin e kësaj figurë në kontekstin e dhënë.

Kërkesa 19 3pikë

Model përgjigjeje

- Nënteksti është ironik. Bankoja i ka kuptuar ndjenjat që e kanë pushtuar Makbethin. Ai e njeh mirë atë, kanë qenë për një kohë të gjatë bashkë, ia njeh trimërinë, forcën por edhe ambicien.

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

- Shafqet dhe dyshues: përderisa një profeci u vërtetua, kanë mbetur dhe dy të tjera, por që ato të realizohen duhen kaluar përmes gjakut. Makbethi vetëm kështu mund të bëhet mbret dhe Bankoja e parandjen këtë.
 - Ndoshta ka dhe një lloj frike. Ç' mund të bëjë Makbethi për t'i realizuar dhe dy profecitë e mbetura? Mos do të kryejë krime? Po Bankoja a rrezikohet nga kjo? Këto janë ndoshta disa nga dilemat që e pushtojnë dhe që i shpreh në këtë varg.
 - Etj.
- 3 pikë** nëse shpjegon qartë nëntekstin e fjalëve të Bankos, duke treguar se e ka kuptuar si duhet thelbin e tragjedisë në tërësi dhe të Makbethit si pjesë e saj si dhe ndjenjat që i shoqërojnë dy heronjtë.
- 2 pikë** nëse shpjegon pjesërisht nëntekstin e fjalëve të Bankos, duke treguar se e ka kuptuar si duhet thelbin e tragjedisë në tërësi dhe të Makbethit si pjesë e saj si dhe ndjenjat që i shoqërojnë dy heronjtë.
- 1 pikë** nëse e kupton nëntekstin, por nuk arrin ta shpjegojë si duhet. Interpretim i lirë. Interpretimi mund të jetë edhe krejtësisht i ndryshëm, por, në çdo rast, ai duhet të jetë i argumentuar dhe mjaft i qartë.

Kërkesa 20 6 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtësore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin).
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike.
- interpreton në mënyrë analitike pjesën.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore.
- përdor si duhet shkronjën e madhe.
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.